



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLITPOPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Sqarim:

Në vijim të një shkrese të dërguar pranë TKOB-së, nga studentët e Universitetit të Artit, sqarojmë se:

Objekti ynë si institucion unik artistik, ishte dhe është, ndërtimi i një urë komunikimi, për të cilin drejtoresha e Përgjithshme e TKOB-së, Abigeila Voshtina, e ka ftuar drejtuesin e Universitetit të Artit që ti japim jetë "Paktit" të firmosur nga ish-ministrja, Elva MARGARITI dhe ish-drejtuesi i TKOBAP-së, Zana ÇELA.

Pakti i UA-së me TKOBAP-në, konsiston me rregullatorin e tij, në ngritjen e një grupi pune i cili nga viti 2019 deri më sot nuk ka qenë asnjëherë aktiv, DHE JO për ARSYE të TKOBAP-së.

Ndërkohë, vetëm nga buxheti i 2023-ishit ka shpenzuar 30.000 euro vetëm për studentet e UA-së që marrin pjesë rregullisht në shfaqjet tona, i cili konsiston në një të katërtën të buxhetit tonë.

1. Janë vënë 4 shfaqje në skenë me Flautin Magjik, ku rolet kryesore kanë qenë 90 % i studenteve të UA-së me profesoreshën Ulpiana Aliaj.

2. Janë bërë masterklase të ndryshme për të gjithë këngëtarët lirik të hapura dhe për studentët.

3. Janë ftuar profesorë të UA-së si rrjedhojë e projekteve që kanë dërguar tek ne në sezonin artistik tonin; Kastriot Tusha, Ardita Bufaj, Xhovana Marku, Marin Gjollma, Dorina Laro.

Artistë shqiptarë me famë ndërkombëtare, Inva Mula, Ermonela Jaho, Gëzim Myshketa, Saimir Pirgu, Eno Peçi, Anxhelin Preljocaj, Leonard Ajkun, Leonard Simaku, Edi Blloshmi, Kostë Deti, Elda Laro etj

Ndër të tjera, ne kemi ftuar edhe Rektorin e UA-së z. Kastriot ÇAUSHI, me anë të një email-i që daton në 07.02.2023, pas 2 takimeve me te.

Janë kryer takime edhe për katedrën e Dirigjimit me z. Dorian Çene dhe asnjë nga diskutimi me planin e punës konkret nuk ka ecur përpara sepse nuk kanë sjellë askënd për të ndjekur planin e provave që në TKOBAP, është në rendin e ditës.

Janë ftuar pianist instrumentiste, pas një takimi të kryer me Zv/Dekanan, znj. Merita Rexha për masterin e M* Dellisanti për "vocal coach", lënde e cila nuk studiohet në UA, dhe pas një dite masterclass janë larguar të gjithë për arsye paaftësie në leximin "aprima vista".

Janë hapur konkurse të shumta në çdo sektor të cilat kanë qenë publike jo vetëm në rrjetet sociale, por edhe në Web dhe APP, duke dashur të mirë-informojmë këdo, si shqiptarë dhe të huaj për arsye se disa nga instrumentet special nuk kanë as numër personash në UA dhe jo më aftësi për

t'i luajtur ato. Rasti konkret i audicionit të instrumentit Korno në të cilin për 3 herë NUK U PARAQIT ASKUSH.

Duke dashur të flasim për politikën e të rinjve, artistë të diplomuar vetëm në sektorin e korit kanë përfituar 4.325,133 ALL, për vitin 2022-2024, dokumente të cilat ndodhen si honorare artistike per produksione të ndryshme pranë zyrës së financës. Ky buxhet konsiston në një të tretën të buxhetit tonë vjetor.

Duke dashur të prek edhe politikën e TKOBAP-së me shtetit fqinj Italian, ju informojmë që po vet ne i kemi shtrirë dorën 52 konservatoreve italiane,

1. Për instrumenta special si Flaut piccolo, Clarinet bass, piccolo, horn basset;
2. Oboe d'amore dhe corno inglese
3. Cornetta dhe tromba egiziane
4. Timpane dhe cimbasso
5. Për te rritur kapacitetin e shfaqjeve tona dhe për të arritur ne objektivat tona Titanike nëpërmjet një buxhet qe nuk shpenzohet aspak nga arka e Teatrit dhe e taksapaguesve Shqiptar, por nga fonde te mirëpërcaktuar me "Thirrje te hapura" dhe "Audicione" te vet këtyre institucioneve.

Ne momentin qe flasim kemi 4 Konservatore që kanë qenë shumë aktiv në kërkesat tona.

Buxheti e te cilave shkon në 57.745 euro nga janari deri ne dhjetor 2023.

Konservatorët renditen si më poshtë;

- 1.Salerno
- 2.Foggia
- 3.La Spezia
- 4.Potenza.

Si dëshmi e network-ut që TKOBAP-ja ka ngritur janë memorandumet me:

1. Filharmonia e Kosovës
2. Teatri i Varnës
3. Teatri i Beogradit dhe Maqedonia e Veriut si politike e "Open Balkan"
4. Konservatori i Salernos, Potenza, Foggia
5. "Fondazione Pucciniano"
6. Diskutim me "Petruzelli"-Bari
7. OSFA Orkestra e Forcave te Armatosura

8. RTSh orkestra dhe televizioni Shqiptare
9. Diskutim "Accademia della Scala"
10. Anëtarësimi në "Opera Base" dhe "Opera Europa"
11. Shkolla e Baletit

Duke dashur gjithmonë të jemi të hapur dhe me bomsence, shpresoj që kjo thirrje të jetë fillimi i një epoke të re BASHKËPUNIMI dhe jo indice për të hedhur baltë mbi punën tonë kolosale 20-mujore.

[Shqiptaria.com]